



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:224668
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05477279

A.C.nr.2763/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.P., nga ..., K.Klinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati N.K., me seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E...” me seli në Rr”...” nr..., Komuna Prishtinë të cilën e përfaqëson, av. I.B. me autorizim në shkresat e lëndës, baza juridike : kompensim dëmi, duke vendosur në bazë të ankesës të paditësit të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.371/16 datë 15.03.2021, dhe ankesën e të paditurës të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.371/16 datë 02.03.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E...” me seli në Rr. “...” nr ..., Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.371/16 datë 02.03.2021, **VËRTETOHET**.

II. REFUZHET e pathemeltë ankesa e paditësit A.P., nga ..., Komuna Klinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë – dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.371/16 datë 15.03.2021, **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Pejë – dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktgjykimin C.nr.371/16 datë 02.03.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. APPROVOHET TËRESISHT SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditësit A.P., nga f.sh ..., K.Klinë, dhe DETYROHET e paditura, Kompania e Sigurimeve “E...” me seli në Prishtinë, Rr”...” nr ..., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të paguaj shumat si vijim:

1.Dëmi jo material:

-Në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike-trupore vlerën në shumë prej 3,000.00€

-Në emër të frikës së përjetuar vlerën në shumën prej 2,300.00€.

-Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, vlerën në shumë prej 3,000.00€

2.Dëmi material:

-Në emër të shpenzimeve për ushqimin e përforcuar vlerën në shumë prej 147,00 euro.

-Ne emër të shpenzime për paaftësi të përkohshme për punë në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve vlerën në shumë prej 540,00 euro.

Në emër të shpenzimeve të shërimi, kontrollit mjekësore, medikamente, dhe shpenzime të udhëtimit vlera në shumë prej 176.10 euro.

Ashtu që vlera e tërësishme për të gjitha llojet e dëmeve materialë dhe jomaterialë arrinë shumën prej 9,163.10 (nëntë mijë, e njëqind e gjashtëdhjetë e tre euro, e dhjetë centë) me kamatë vjetore 8%, e llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit deri në përmbushjen definitive bashkë me shpenzimet procedurale në shumën prej 2,067 euro € të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcenim të përmbarimit me dhunë...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të: *shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike* me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovojë si të bazuar këtë ankesë, aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë sa i përket kompensimit të dëmit material.

Me datë 10.03.2021, paditësi ka parashtruar në Gjykatë propozim për plotësimin e aktgjykimit C.nr.371/2019 datë 02.03.2021.

Gjykata Themelore në Pejë – dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin C.nr.371/16 datë 15.03.2021, e ka hedhë poshtë si të pathemeltë propozimin e paditësit, për plotësimin e aktgjykimit C.nr.371/2019 datë 02.03.2021.

Kundër aktgjykimit.nr.371/2019 datë 02.03.2021, dhe aktvendimit C.nr.371/16 datë 15.03.2021 brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesë palët ndërgjyqëse dhe i kanë propozuar Gjykatës së Apelit që aktgjykimin/Aktvendimin e atakuar ta prishë, dhe lëndën ta kthejë në rivendosje dhe rigjykim, ose ta ndryshoj duke marrë për bazë kundërshtimet e palëve ndërgjyqëse.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin/Aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesat e palëve ndërgjyqëse janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi me datë 08.02.2016, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur padi ndaj të paditurës, me kërkesë për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë, pasi ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 02.03.2021, dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, dëgjimit të ekspertëve mjekësor, me Aktgjykimin C.nr.371/2016 datë 02.03.2021, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur me shumë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera e ka arsyetuar se "...Me qe nga pala e paditur në fillim të seancës përgatitore, si dhe në fjalën përfundimtare kontestohet baza juridike e kërkesëpadisë, me propozimin e palëve ndërgjyqëse, gjykata nxjerri provën përmes ekspertizës nga lëmia e komunikacionit, gjë qe pas mendimit dhe konstatimit profesional të ekspertit të komunikacionit dr N.D., në bazë të të cilit u vërtetua qartë se shkaktar i vetëm i aksidentit të komunikacionit është i siguruari i palës se paditur, se shpejtësia e lëvizjes së automjetit A në momentin e paraqitjes së rrezikut e deri tek kontakti me lisin është 60-65km/h ku shpejtësia e lëvizjes së automjetit A në momentin e kontaktit me lisin në bazë të deformimit të automjeteve është 40+5km/h, ndërsa shpejtësia e lëvizjes së automjetit A në momentin e paraqitjes së rrezikut e deri tek kontakti me lisin është 97-102 km/h. Nga foto 2 shohim se nuk ka deformim në xhamin ere-mbrojtës, me rast mund të konstatohet se pasagjeri i automjetit në momentin e kontaktit të automjetit me lise ka qenë i lidhur me rryp të sigurisë. Duke analizuar situatën e krijuar konstatoj se drejtuesi i automjetit duke zhvilluar shpejtësinë e lëvizjes me të madhe se shpejtësia e kufizuar (97-102 km/h) teknikisht kontribuon që të vije deri të aksidenti i komunikacionit rrugorë. Andaj në këtë kontekst edhe pse ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë nga e paditura e njëjta i ofroi ofertën paditësit vlerën në shumë prej 5,000 euro në emër të përmbushjes së detyrimeve për të gjitha llojet e dëmit materialë dhe jo material të shkaktuara në aksidentin e komunikacionit nga i siguruari i të paditurës..."

Me datë 10.03.2021, paditësi ka parashtruar në Gjykatë propozim për plotësimin e aktgjykimit C.nr.371/2019 datë 02.03.2021.

Gjykata Themelore në Pejë – dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin C.nr.371/16 datë 15.03.2021, e ka hedhë poshtë si të pathemeltë propozimin e paditësit, për plotësimin e aktgjykimit C.nr.371/2019 datë 02.03.2021.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera e ka arsyetuar se *“...Andaj nga dispozitat ligjore te larte theksuara, lidhur me plotësimin e aktgjykimit në fjalë, gjykata vie deri tek përfundimi se nuk ka të drejtë te vendos diçka me shume se qe ka kërkuar pala me padi apo siç theksohet ne parimin e të drejtës civile ultra et extra petitum...”*.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit/Aktvendimit për arsye se aktgjykimi/Aktvendim i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ku nuk ishte kontestuese baza juridike në këtë procedurë kontestimore, pasi që edhe e paditura në seancën gjyqësore të mbajtur në Gjykatë me datë 10.11.2020 ndër të tjera ka deklaruar se *“...ne bazë të kësaj ekspertize nuk ka ndarje te përgjegjësis, andaj kompania E... eshte përgjegjëse njëqind per qind per kompensimin e demit material dhe jo material...”*, andaj Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike në këtë çështje është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike, për të cilat arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ka vendosur drejtë, pasi paditësit i takon e drejta në kompensim të dëmit jo material dhe material duke u bazuar në dispozitat e nenit 136,169,183 dhe nenit 961 të LMD-së, si dhe nenit 323 të LPK-së, andaj shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar për paditësin A.P., për dëmin jo material, për dhimbje trupore- fizike, shumën prej 3.000,00€, kjo shumë e gjykuar është reale duke u bazuar në mendimin e ekspertit Dr.S.D., ortoped-traumatolog i cili në bazë të dokumentacionit mjekësor për paditësin, ndër të tjera kanë dhënë mendim se paditësi, kanë pësuar lëndime të rënda trupore, që tek paditësi ka shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit, e duke marrë parasysh këtë vlerësim mjekësor shuma e gjykuar është e drejtë.

Aktgjykimi i atakuar sa i përket shumës së gjykuar prej 2.300,00€ për paditësin A.P., për frikën e përjetuar, është vërtetuar, duke marrë parasysh mendimin e ekspertëve mjekësor ku ndër të tjera kanë deklaruar, pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor të paditësi, lidhur me frikën e përjetuar, ka konstatuar se paditësi A.P., në aksidentin e pësuar, ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur 1 deri në 2 sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur një muaj, frikë sekondare të intensitetit më të ultë e cila ka zgjatur një muaj, , andaj shuma e gjykuar është e drejtë dhe e arsyeshme.

Aktgjykimi i atakuar sa i përket shumës së gjykuar prej 3000,00€ për paditësin A.P., për zvogëlimin e aktivitetit jetësor, është vërtetuar, duke marrë parasysh mendimin e ekspertit mjekësor Dr.S.D., i cili ekspert në mendimin e dhënë ndër të tjera ka deklaruar se “ *...Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 10%...*”, andaj shuma e gjykuar është e drejtë dhe e arsyeshme.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si reale shumën sa i përket vendosjes së kompensimit të paditësit për ushqimin e përforcuar, ndihmës së personit të tretë, dhe në emër të shpenzimeve të shërimit, ku edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar, pasi në bazë të mendimit të ekspertit mjekësor, i cili ka vlerësuar se paditësi A.P, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, në kohëzgjatje prej 3 javësh, dhe ndihmën e personit në kohëzgjatje prej 4 javëve pas aksidentit, rehabilitim fizioterapeutik në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke u bazuar edhe në provat që gjinden në shkresat materiale, andaj këtë pjesë edhe e ka vërtetuar, si reale dhe të drejtë.

Pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 pika n), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, nuk qëndronë pasi që dispozitivi i Aktgjykimit është i kuptueshëm, i kjashtë dhe arsyetimi i Aktgjykimit përmban të gjitha faktet vendimtare, dhe arsyet pse është vendosë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Pretendimi ankimor i të paditurës se Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale sa i përket bazës dhe kontributit të pjesëmarrësve në aksident, ky pretendim është i pa bazuar pasi që e paditura në seancën gjyqësore të mbajtur në Gjykatë me datë 10.11.2020 ndër të tjera ka deklaruar se “*...ne bazë të kësaj ekspertize nuk ka ndarje të përgjegjësis, andaj kompania E... është përgjegjëse njëqind per qind per kompensimin e demit material dhe jo material...*”.

Gjykata e Apelit vlerëson si të pa bazuara pretendimet në ankesë të palës së paditur se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, sa i përket lartësisë së kompensimit, pasi vlerëson se shumatat e gjykuara nga Gjykata në shkallë të parë, janë reale duke u bazuar edhe në lëndimet e pësuar nga paditësi.

Pretendimi ankimor i të paditurit se aktvendimi i ankimuar ka shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.371/2016 datë 02.03.2021, ka vendos duke u bazuar në

Numri i lëndës: 2019:224668
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05477279

shkresat e lëndës, ndërsa për shpenzimet e procedurës kontestimore ka vendosur duke u bazuar në nenin 449, dhe 452.1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.2763/21 datë 18.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi